



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË**

**RAPORT I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE  
PËR PERIUDHËN JANAR/QERSHOR - 2021**

**KORRIK/2021**

**P Ë R M B A T J A**

1. Hyrja.....	3
2. Analiza e Buxhetit.....	6
3. Pasqyra e realizimit të buxhetit e strukturuar sipas kategorive ekonomike .....	7
4. Shpalosja e pasqyrave të shpenzimeve të strukturuar nëpër kategori ekonomike...9	
4.1 Paga dhe mëditje .....	9
4.2 Mallra dhe shërbime.....	13
4.3 Shpenzime komunale.....	15
4.4 Subvencione dhe transfere.....	16
4.5 Investime kapitale.....	17
5. Të hyrat vetanake.....	19
6. Të hyrat nga donacionet.....	24

## 1. HYRJE

Bazuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048, neni 45 pika 45.2 lidhur me raportet tremujore buxhetore, Statutit të Universitetit të Mitrovicës neni 29 përgjegjësitë e rektorit pika 1.9 lidhur me menaxhimin e buxhetit dhe mjeteve në kuadër të shumës së miratuar nga Këshillim Drejtues i Universitetit të Mitrovicës, rektori i Universitetit të Mitrovicës përmes zyrës për buxhet dhe financa ka hartuar raportin mbi planifikim dhe realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar/qershor të vitit fiskal 2021.

Raporti përmban një analizë përmbljedhëse të performancës së aktiviteteve të planifikuara të cilat ndërlidhen me objektivat e planifikuara sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2021/2023, Ligjit mbi Ndarjen Buxhetore për vitin 2021 për Universitetin e Mitrovicës, Planit Strategjik (i rishikuar) 2019/2021 për Universitetin e Mitrovicës, vendimeve dhe rekomandimeve të Këshillit Drejtues dhe menaxhmentit të UIBM.

Raporti, përmes pasqyrave financiare, pasqyron se në ç'mënyrë institucioni i Universitetit të Mitrovicës bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore për vitin 2021, administroi: burimet financiare dhe shpenzimet

Pasqyrat financiare për periudhën raportuese janë të bazuara në dokumentet:

1. Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë-pasqyrimi i pasqyrave financiare.
2. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021-2023.
3. Ligji mbi Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.
4. Statuti i UIBM.
5. Buxheti për vitin 2021 për UIBM
6. Planin e rrjedhës së parasë të bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore për vitin 2021


Pasqyrat financiare janë të harmonizuara me të dhënat e sistemuara në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës (SIMFK).

**Buxheti për Universitetin "Isa Boletini" - Mitrovicë i bazuar në Ligjin për Buxhetin të Republikës së Kosovës Nr.07/L-041**

Buxheti për UIBM konform Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr.07/L-041 është 3.884.906.00 euro që në krahasim me buxhet të vitit 2020 është më i ulët për 326.339.00 euro ose me indeks prej 7.75% .

Buxheti i strukturuar nëpër kategori ekonomike

	KATEGORIA EKONOMIKE	Buxheti për vitin fiskal 2021
1.	PAGA DHE MËDITJE	2.879.706.00
2.	MALLRA DHE SHËRBIME	450.000.00
3.	SHPENZIME KOMUNALE	215.200.00
4.	SUBVENCIONE	100.000.00
5.	INVESTIME KAPITALE	240.000.00
6.	GJITHSEJ	3.884.906.00



**Buxheti i strukturuar sipas kategorive ekonomike dhe burim të financimit**

	KATEGORIA EKONOMIKE	Buxheti për vitin fiskal 2021	Burimet e financimit	
			Buxheti i Kosovës	Të hyrat vetanake
1.	PAGA DHE MËDITJE	2.879.706.00	2.765.045.00	114.661.00
2.	MALLRA DHE SHËRBIME	450.000.00	450.000.00	
3.	SHPENZIME KOMUNALE	215.200.00	215.200.00	
4.	SUBVENCIONE	100.000.00	100.000.00	
5.	INVESTIME KAPITALE	240.000.00	240.000.00	
6.	GJITHSEJ	3.884.906.00	3.770.245.00	114.661.00


**Paga dhe mëditje** - për vitin fiskal 2021 masa buxhetore e planifikuar për përmbushjen e obligimeve për paga është 2.879.706.00 euro që është në nivelin e pagave të planifikuara për vitin 2020.

**Mallra dhe shërbime** - Masa buxhetore për këtë kategori është 450.000.00 dhe është më e lartë për 83.661.00 në krahasim me vitin fiskal 2020.

**Shpenzime Komunale**- shpenzimet komunale janë 215.200.00 dhe janë në nivelin e vitit fiskal 2020.

**Subvencionet**- mjetet e planifikuara janë në shumë prej 100.000.00 euro dhe janë në nivelin e vitit 2020.

**Investime kapitale**- Investimet kapitale për këtë vit fiskal janë planifikuar me shumë prej 240.000.00 euro dhe janë më të ulëta për 410.000.00 euro në krahasim me vitin 2020.



## 2. ANALIZA E BUXHETIT

Buxheti i strukturuar nëpër kategori ekonomike i bazuar në kufijtë final të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës për Universitetin e Mitrovicës pasqyron mundësinë e realizimit të aktiviteteve të cilat ndërlidhen me fushëveprimin e Universiteteve publike.

Buxheti për UIBM konform Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr.07/L-041 është 3.884.906.00 euro që në krahasim me buxhet të vitit 2020 është më i ulët për 326.339.00 euro ose me indeks prej 7.75% .

Për periudhën raportuese (janar-qershor) janë alokuar mjete në shumë prej 1.968.833.06€ ose 50.67% të buxhetit të aprovuar. Realizimi i buxhetit për të njëjtën periudhë është me indeks prej 83.02%(1.634.691.40€) bazuar në alokimin e mjeteve ose me indeks prej 42.07% në krahasim me buxhetin e aprovuar. Mjetet e angazhuara për këtë periudhë janë në shumë prej 1.854.112.85€ ose 94.17% të mjeteve të alokuara.

Periudha janar/qershor karakterizohet për racionalizim të shpenzimeve duke përcaktuar edhe prioritetet që ndërlidhen me realizimin e kërkesave të njësive akademike dhe zyrave administrative në nivel të UIBM. Vëmendje e posaçme ju kushtua procesit për riakreditim të programeve të njësive akademike, pajisjes së laboratorëve me pajisje, mjete të cilat do të jenë të destinuara për funksionalizim për laboratorë si dhe botimin e librave shkencor të dedikuara për student të Universitetit.

Zyra për buxhet dhe financa bartëse e procesit dhe mbikëqyrjes së realizimit është përqendruar që kërkesat të jenë të harmonizuara me planifikimin e shpenzimeve të bazuar në planin e rrjedhës së parasë së gatshme për të njëjtën periudhë. Planifikimi i aktiviteteve për funksionalizim të kampusit të ri universitar, ngritja e nivelit të shërbimeve për student dhe jo vetëm ishin prioritetet të përcaktuara nga menaxhmenti. Ndarja e mjeteve për kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime në shumë prej 319.450€ ose me indeks prej 70.98% të buxhetit të aprovuar pasqyron përkushtimin për qasje për funksionalizim të kampusit që ndërlidhet me aktivitete të cilat janë pasqyruar në Planin Strategjik të rishikuar për vitet 2019/2021.

Zvogëlimi i masës buxhetore për investime kapitale në shumë prej 410.000.00€ në krahasim me vitin fiskal 2020 do të ndikoj në realizimin e objektivave të planifikuara për krijim të vlerës së shtuar për funksionalizim të laboratorëve të njësive akademike e të cilat janë në harmoni me kërkesat e tregut të punës.

Realizimi i buxhetit për periudhën janar/qershor/2021 në indeks të realizimit prej 83.02% të mjeteve të alokuara mund të karakterizohet si mjaft i suksesshëm duke pas për bazë racionalizimin e shpenzimeve. Indeksi i realizimit për të njëjtën periudhë është më i lartë për 6.25% në krahasim me indeksin e realizimit të vitit 2020 (1.504.658.45€).

Në tabelën e poshtë shënuar është pasqyruar planifikimi, alokimi dhe realizimi i buxhetit për periudhën raportuese janar/qershor/2021 në raport me buxhetet e aprovuara për vitet fiskale 2019/2021.

Kategoritë ekonomike	Buxheti i planifikuar bazuar në Ligjin mbi buxhetin 2019	Buxheti i planifikuar bazuar në Ligjin mbi buxhetin 2020	Buxheti i planifikuar bazuar në Ligjin mbi buxhetin 2021	Mjetet e shpenzuara Janar/qershor 2019	Mjetet e shpenzuara Janar/Qershor 2020	Mjetet e shpenzuara Janar/Qershor 2021	Indeksi 2019	Indeksi 2020	Indeksi 2021
1	2	3	4	5	6	7	8=5/2*100	9=6/3*100	10=7/4*100
Paga & Mëditje	2.757.430.00	2.879.706.00	2.879.706.00	1.228.522.14	1.110.944.18	1.275.845.06	44.55	42.66	44.30
Mallra&Shërbime	866.339.00	366.339.00	450.000.00	118.180.13	132.589.45	179.290.82	13.64	36.19	39.84
Shpenzime komunale	215.200.00	215.200.00	215.200.00	67.828.31	54.746.71	101.614.99	31.51	25.43	47.23
Subvencione	100.000.00	100.000.00	100.000.00	55.000.00	29.520.00	12.335.80	55.00	29.52	12.33
Kapitalet	850.000.00	650.000.00	240.000.00	97.489.00	176.858.11	65.604.73	11.47	27.20	27.33
Total	4.788.969.00	4.211.245.00	3.884.906.00	1.567.019.58	1.504.658.45	1.634.691.40	32.72	35.72	42.07

### Pasqyrë e planifikimit dhe realizimit të buxhetit për vitet fiskale 2019/2021/alokimi i mjeteve

Kategoritë ekonomike	Alokimi Janar/ qershor 2019	Alokimi Janar Qershor 2020	Alokimi Janar Qershor 2021	Mjetet e shpenzuara Janar/qershor 2019	Mjetet e shpenzuara Janar/Qershor 2020	Mjetet e shpenzuara Janar/Qershor 2021	Indeksi 2019	Indeksi 2020	Indeksi 2021
1	2	3	4	5	6	7	8=5/2*100	9=6/3*100	10=7/4*100
Paga & Mëditje	1.228.522.14	1.110.944.18	1.283.924.06	1.228.522.14	1.110.944.18	1.275.845.06	100	100	99.37
Mallra&Shërbime	700.792.43	250.831.50	319.450.00	118.180.13	132.589.45	179.290.82	16.86	52.86	56.12
Shpenzime komunale	85.276.00	107.600.00	110.459.00	67.828.31	54.746.71	101.614.99	79.53	53.66	91.99
Subvencione	100.000.00	50.000.00	25.000.00	55.000.00	29.520.00	12.335.80	55.00	59.04	49.34
Kapitalet	850.000.00	440.509.20	230.000.00	97.489.00	176.858.11	65.604.73	11.47	40.15	28.52
Total	2.964.590.57	1.959.884.88	1.968.833.06	1.567.019.58	1.504.658.45	1.634.691.40	52.82	76.77	83.02

### 3. PASQYRA E REALIZIMIT TË BUXHETIT E STRUKTURUAR SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE


Zyra për buxhet dhe financa bartëse e procesit të ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së buxhetit përmes pasqyrave financiare pasqyron: si është bërë menaxhimi i parasë publike duke analizuar dhe bërë krahasime me planifikim, burimet dhe realizim të mjeteve të strukturuar në kategori ekonomike. Për periudhën raportuese (janar-qershor) janë alokuar mjete në shumë prej 1.968.833.06 € ose 50.67% të buxhetit të aprovuar. Realizimi i buxhetit është me indeks prej 83.02 % (1.634.691.40€) bazuar në alokimin e mjeteve.

Buxheti i planifikuar i bazuar në Ligjin mbi buxhetin për 2021	Alokimi Janar/Qershor/2021	Mjetet e shpenzuara Janar/Qershor	Indeksi i realizimit në raport me Ligjin e aprovuar mbi buxhetin 2021	Indeksi i realizimit në raport me alokimin e mjeteve
1	2	3	4=3/1*100	5=3/2*100
3.884.906.00	1.968.833.06	1.634.691.40	42.07	83.02

Në tabelën e poshtëshënuar është pasqyruar realizimi i buxhetit i krahasuar me burim, alokim, zotim, realizim dhe indeks të realizimit.

Kategoritë ekonomike	Buxheti i planifikuar bazuar në Ligjin mbi buxhetin 2021	Alokimi Janar/Qershor	Mjetet shpenzuara Janar/Qershor	Zotimet në pritje	Mjetet angazhuara	Mjetet e pashfrytëzuara	Mjetet e angazhuara në %	Shpenzimi i buxhetit në %
	1	2	3	4	5=3+4	6=2-5	7=5/2*100	8=3/2*100
Paga & Mëditje	2.879.706.00	1.283.924.06	1.275.845.06		1.275.845.06	8.079.00	99.37	99.37
Mallra&Shërbime	450.000.00	319.450.00	179.290.82	105.070.77	284.361.59	35.088.41	89.01	56.12
Shpenzime komunale	215.200.00	110.459.00	101.614.99		101.614.99	8.844.01	91.99	91.99
Subvencione	100.000.00	25.000.00	12.335.80		12.335.80	12.664.20	49.34	49.34
Kapitalet	240.000.00	230.000.00	65.604.73	114.350.68	179.955.41	50.044.59	78.24	28.52
Total	3.884.906.00	1.968.833.06	1.634.691.40	219.421.35	1.854.112.85	114.720.21	94.17	83.02

### Pasqyre e alokimit,realizimit,zotimit dhe mjetet e pashfrytezuara



**Pagat dhe mëditjet** - janë alokuar 1.283.924.06 € për përmbushjen e obligimeve për paga për personelit akademik të rregullt, të angazhuar dhe personelin administrativ. Për periudhën raportuese janë realizuar 1.275.845.06€ ose me indeks të realizimit prej 99.37% përkatësisht janë shpenzuar mjete me indeks prej 44.30% të mjeteve të planifikuara (2.879.706.00 euro) sipas buxhetit të aprovuar.

**Mallrat dhe shërbimet** janë alokuar 319.450.00€ ose me indeks prej 70.98% të mjeteve të planifikuara sipas buxhetit të aprovuar. Mjetet e alokuara janë realizuar në shumë prej 179.290.82€ euro ose me indeks prej 56.12 % në krahasim me mjetet e alokuara.

**Shpenzimet komunale** janë alokuar 110.459.00€ dhe janë realizuar 101.614.99€ ose me indeks prej 91.99% në krahasim me mjetet e alokuara.



Subvencionet dhe transferet –janë alokuar 25.000.00€, janë realizuar 12.335.80€ me indeks të realizimit 49.34% në krahasim me buxhetin e alokuar.

Investimet kapitale -sipas planit të rrjedhës së parasë janë alokuar 230.000.00 janë realizuar 65.604.73€ ose me indeks të realizimit prej 28.52% në krahasim me buxhetin e alokuar.

#### 4. SHPALOSJA E PASQYRAVE TË SHPENZIMEVE TË STRUKTURUARA NËPËR KATEGORI EKONOMIKE

##### 4.1 PAGA DHE MËDITJE

Buxheti i aprovuar sipas Ligjit mbi Ndarjen Buxhetore për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje është 2.879.706.00 euro i planifikuar për përmbushjen e obligimeve ndaj 195 të punësuarve ( 128 personel akademik dhe 67 personel administrativ) dhe 4 anëtar të KD të UIBM Bazuar në strukturën organizative, numrin e planifikuar dhe rregulloren mbi të ardhurat personale të aprovuar nga Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës, masa e planifikuar buxhetore mbulon të gjitha pozitat e planifikuara sipas strukturës organizative për personel akademik, administrativ dhe anëtar të KD.

Pasqyrë e strukturës së personelit të bazuar në numrin e lejuar sipas Ligjit mbi buxhetin për UIBM

nr	Gjendja në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje-Universiteti i Mitrovicës/numri i personelit									
kodi	MASHTI	Nr. i aprovuar sipas Ligjit mbi Ndarjen buxhetore për UMIB vitit 2021	Numri aktual të punësuarve për personelin akademik i rregullt- paga e qershorit/2021	Numri aktual i të punësuarve-personelit akademik i angazhuar - paga e qershorit/2021	Numri aktual i të punësuarve për personelin administrativ - paga e qershorit/2021	Numri aktual i të punësuarve për personelin: akademik i rregullt, i angazhuar dhe p. Administrativ - paga e qershorit/2021	Vendet e lira në krahasim me numrin e lejuar sipas Ligjit mbi Buxhetin për vitin 2021	vende të lira për personel akademik	Vendet e lira për personel administrativ	Tejkallim te numrit te lejuar sipas Ligjit mbi Buxhetin për vitin 2021
1	2	3	4	5	6	7=4+5+6	8=3-(4+6)	9	10	11
979	UIBM	195	107	31/12	57	176	31	21	10	-
979	Anëtar te Këshillit Drejtues	4								
	totali	199	107	12	57	176	31	21	10	-

Universiteti i Mitrovicës ka të hartuar planin e personelit për vitin 2021 për administratë dhe personel akademik i cili është i bazuar në strukturën organizative të aprovuar, numrin aktual dhe numrin e vendeve të lira. Plani nënkupton edhe disponueshmërinë e mjeteve për të mbuluar obligimet ndaj personelit aktual dhe plotësimin e vendeve të lira.

## STRUKTURA E PERSONELIT AKADEMIK SIPAS THIRJEVE AKADEMIKE

NR	Personeli akademik sipas thirrjeve	Numri aktual	Vendet e lira	Gjithsej sipas strukturës organizative
1	1	2	3	4=2+3
2	Profesor i rregullt	22		22
3	Profesor i asocuar	21	4	25
4	Profesor asistent	32	7	39
5	Ligjërues	2		2
6	Asistent	30	10	40
7	Gjithsej	107	21	128

## PERSONELI ADMINISTRATIV

NR	POZITËS/VENDI PUNËS	Numri i të punësuarve	Vendet e lira	Gjithsej sipas strukturës organizative
	1	2	3	4=2+3
1	Sekretar ne UIBM	1		1
2	Drejtor i zyrës administrative	7	2	9
3	Auditor		1	1
4	Sekretar në njësi akademike	4	2	6
5	Zyrtar administrative 5	16	2	18
6	Zyrtar administrative 3	9	1	10
7	Zyrtar administrative 3	16	1	17
8	Zyrtar administrative 2	2		2
9	Zyrtar administrative 3	2	1	3
10	Gjithsej	57	10	67

Në tabelën e poshtë shënuar është pasqyruar realizimi i pagave për periudhën janar/qershor në raport me alokimin e mjeteve për të njëjtën periudhë.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Paga e planifikuar bazuar në Ligjin mbi ndarjen buxhetore për vitin 2021	Alokimi i mjeteve Janar-Qershor/ 2021	Pagat e realizuara Janar-Qershor/ 2021	Indeksi i realizimit në raport me mjetet e alokuara për Janar-Qershor /2021
		2	3	4	5=4/3*100
1.	PAGA DHE MËDITJE	2.879.706.00	1.283.924.06	1.275.845.06	99.37


Sipas planit të rrjedhës së parasë për periudhën raportuese është planifikuar (sipas rregullave të MF 1/12 e pagës totale) shuma prej 1.439.853.00 €, janë alokuar 1.283.924.06€ kurse janë shpenzuar 1.275.845.06 euro. Mjetet janë realizuar me indeks prej 99.37% në krahasim me mjetet e alokuara. Bazuar në metodologjinë e aplikuar nga MF,UIBM për këtë periudhë ka suficit prej 164.007.94€. Mbetja do të shpërndahet varësisht nga nevoja për të plotësuar numri i pozitive të lira për vitin fiskal 2021.

Nr	Planifikimi i pagave për periudhën janar/qershor të bazuar në planin e rrjedhës së parasë për vitin 2021	Alokimi i mjeteve për periudhën janar/qershor	Realizimi i pagave për periudhën janar/qershor	Mbetja e buxhetit për periudhën janar/mars
	1	2	3	4=1-3
1.	1.439.853.00	1.283.924.06	1.275.845.06	164.007.94

## Pasqyra e realizimit të pagave të planifikuara, të strukturuar sipas realizimit mujor për UIBM

nr	UMIB	Personeli administrati	shuma	Personel Akademik	shuma	Personel akademik angazhuar	shuma	Anëtar Këshillit	Shuma	totali	totali
1	JANAR	56	34489.36	109	154483.3	22	2744.18	4	892.5	194	192609.3
2	SHKURT	55	35552.13	107	166877.5	27	10668.76	4	1422.75	190	214521.1
3	MARS	55	35373.98	108	161750.9	27	4390.55	4	903	191	202418.4
4	PRILL	55	35370.29	108	173315.53	30	11453.48	4	905	197	221044.3
5	MAJ	55	34141.73	108	174031.15	31	14418.6	4	1540.67	198	224132.15
6	QERSHOR	57	36980.66	107	174042.05	31	9191.68	4	905.42	199	221119.81
7	Gjithsej		211908.15		1004500.4		52867.25		6569.34		1275845.06


Nga pasqyra e lartë shënuar vërehen se shuma prej 1.004.500.40€ është realizuar për personelin akademik ose 78.73% të totalit të realizuar (1.275.845.06€) për personelin akademik të angazhuar janë realizuar 52.867.25€ euro ose 4.14% dhe për personelin administrative të strukturuar në administratën qendrore(rektorat) dhe njësitë akademike shuma prej 211.908.15 euro ose 16.61% dhe shuma prej 6.569.34€ për Anëtarët e Këshillit Drejtues ose 0.51 të shumës së shpërndarë për periudhën raportuese.



Pasqyrë e realizimit të pagave të strukturuar sipas njësive akademike dhe administratë qendrore/rektorat

Njësia akademike	JANAR	SHKURT	MARS	PRIL	MAJ	QERSHOR	TOTALI
KËSHILLI DREJTUES	892.5	1,422.75	903	905	905.00	905.42	5933.67
FGJ	42,673.90	50,772.08	43382.47	50,725.73	49,948.99	48,975.51	286478.676
FIMK	28,047.34	32,932.18	33343.72	35,936.58	37,077.41	36363.86	203701.084
FTU	34,692.21	33,459.09	34,872.39	36,499.09	35,692.94	34,834.14	210049.857
EDUKIM	18,200.33	23,125.88	21,344.56	25,920.75	30,868.22	26,751.82	146211.564
JURIDIK	16,136.03	17,211.99	16,347.67	18,047.28	17,826.78	18,605.82	104175.573
EKONOMIK	17,128.71	19,775.50	17,469.11	17,639.58	17,671.08	17,702.58	107386.567
REKTORATI	34,489.36	35,552.13	35,373.98	35,370.29	34,141.73	36,980.66	211908.15
TOTALI	192,260.38	214,251.59	203036.9	221,044.30	224,132.15	221119.81	1275845.13

Pasqyre e realizimit te pagave te strukturuar sipas njesive akademike dhe administrate qendrore/rektor



Pasqyrë krahasuese e realizimit të pagave për vitet 2019/2021

Nr	Periudha e raportimit	Paga e realizuar
1	Periudha janar/qershor/2019	1.228.522.16
2	Periudha janar/qershor/2020	1.110.944.20
3	Periudha janar/qershor/2021	1.275.845.06

Pasqyre krahasuese e realizimit te pagave per vitet 2019/2021



#### 4.2 MALLRA DHE SHËRBIME

Për periudhën janar/qershor bazuar në planin e rrjedhës së parasë janë alokuar mjete në shumë prej 319.450.00€, janë realizuar 179.290.82€ ose me indeks të realizimit prej 56.12% në krahasim me mjetet e alokuara. Mjete të zotuar janë në shumë prej 105.070.77€/në pritje, për periudhën raportuese janë angazhuar 284.361.59€ ose me indeks të angazhimit prej 89.01 % më krahasim me mjetet e alokuara.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi i mjeteve sipas buxhetit/2021	Alokimi janar /qershor/2021	Mjetet shpenzuara - janar /qershor/2021	Mjetet e zotuar - janar/qershor	Indeksi i realizimit
		1	2	3	4	5=3/2*100
1.	MALLRA DHE SHËRBIME	450.000.00	319.450.00	179.290.82	105.070.77	56.12%

Në tabelën e poshtëshënuar janë pasqyruar shpenzimet të strukturuar nëpër kode ekonomike duke bërë krahasime me mjetet e planifikuara sipas ndarjes buxhetore, alokimin e mjeteve dhe realizimin për periudhën raportuese.

KODI EKONOMIK	KATEGORIA EKONOMIKE	MJETET E SHPENZUARA JANAR - QERSHOR/2020	ALOKIMI I MJETEVE JANAR- QERSHOR/2021	MJETET E SHPENZUARA JANAR - QERSHOR/2021	ZOTIMI I MJETEVE JANAR- QERSHOR/2021	MJETET E ANGAZHUARA JANAR- QERSHOR /2021
	1	2	3	4	5	6=4+5
013000	Mallrat dhe shërbimet	132,589.45	319,450.00	179,290.82	105,070.77	284,361.69
013100	Shpenzimet e udhëtimit	4,808.71				
013130	Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit					
013140	Shpenzimet e udhëtimeve zyrtare	4,808.71				
013141	Shpenzimet te vogla - para xhepi					
013142	Akomodimi - udhëtimet zyrtare jashtë					
013143	Shpenzime tjera - udhëtimeve zyrtare					
013300	Shërbimet e telekomunikimit	6,385.26	13,818.20	11,683.00	995.00	12,678.00
013310	Shpenzimet për Internet		1,500.00	413.00	995.00	1,408.00
013320	Shpenzime e telefonisë mobile	6,385.26	10,800.00	11,270.00		11,270.00
013330	Shpenzimet postare		318.20			
013340	Shpenzimet për përdorim të kabllot		1,200.00			
013400	Shpenzimet për shërbimet	23,279.23	106,832.00	64,295.45	20,792.38	85,051.83
013410	Shërbimet e arsimit dhe trajnimit		12,332.00	2,037.00		2,037.00
013440	Shërbimet e përfaqësimit dhe		5,000.00			
013430	Shërbime të ndryshme shëndetësore					
013440	Shërbime të ndryshme intelektuale		8,000.00			
013450	Shërbime shtypje-jo marketing		15,000.00	2,250.00	9,500.00	11,750.00
013460	Shërbime tjera kontraktuese	22,569.23	60,000.00	60,008.45	11,292.38	71,300.83
013470	Shërbimet teknike		5,000.00			
013480	Shpenzimet për anëtarësim	710.00	1,500.00			
013495	Pagesa për Vendime Gjyqësore					
013500	Blerja e mobilieve dhe pajisjeve më	33,972.14	37,385.18	852.00	37,912.00	38,764.00
013501	Mobile	28,750.00				
013502	Telefona					
013503	Kompjuterë		10,000.00			

013504	Harduer për teknologji informative					
013505	Makina fotokopiuere					
013506	Pajisje speciale mjekësore					
013507	Pajisje të shërbimit policor					
013508	Pajisje trafiku					
013509	Pajisje tjera	5,222.14	27,385.18	852.00	37,912.00	38,764.00
013600	Blerje tjera të mallrave dhe shërbimeve		14,500.00	11,379.45	7,521.00	18,900.45
013610	Furnizime për zyrë		5,000.00	9,148.30		9,148.30
013611	Furnizim me dokumente blanko		1,000.00			
013620	Furnizim me ushqim dhe pije- jo dreka		1,000.00	1,926.00		1,926.00
013630	Furnizime mjekësore (organizata					
013640	Furnizime pastrimi		500.00			
013650	Furnizim me veshmbathje		1,000.00			
013655	Furnizim me preparate kimike				7,521.00	7,521.00
013660	Akomodimi		6,000.00	305.15		
013670	Municion dhe armë zjarri					
013680	Tiketa Siguruese					
013681	Bllombat					
013700	Derivatet dhe lëndët djegëse	955.12	2,343.13	658.88		658.00
013710	Vaj					
013720	Naftë për ngrohje qendrore					
013730	Vaj për ngrohje					
013740	Mazut					
013750	Qymyr					
013760	Dru					
013770	Derivate për gjenerator					
013780	Karburant për vetura	955.12	2,343.13	658.88	658.00	
013800	Llogarite e avansit	1,000.00	11,000.00	1,000.00		
013810	Avans për para të imëta(p.cash)	1,000.00	2,000.00	1,000.00		
013820	Avans për udhëtime zyrtare		9,000.00			
01395	Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	25,872.90	41,476.99	27,206.97	12,232.03	39,439.00
013950	Regjistrimi i automjeteve		1,500.00			
013951	Regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve					
013952	Taksat komunale e regjistrimit të		500.00			
013953	Sigurimi i ndërtesave dhe tjera	25,872.90	39,476.99	27,206.97	12,232.03	39,439.00
014000	Mirëmbajtja	31,322.16	79,640.00	56,467.97	24,588.36	81,506.33
014010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve		1,500.00			
014020	Mirëmbajtja e ndërtesave	20,002.16	56,140.00	34,003.72	22,154.31	56,158.03
014040	Mirëmbajtja e teknologjisë informative	11,320.00	20,500.00	19,889.00	1,919.00	21,808.00
014050	Mirëmbajtja e mobilieve dhe pajisjeve		1,500.00	2,575.25	515.05	3,090.30
014200	Shpenzimet e marketingut	815.00	7,000.00	1,670.00	1,030.00	2,700.00
014210	Reklamata dhe konkurset		2,000.00		990.00	990.00
014220	Botimet e publikimeve		1,000.00			
014230	Shpenzimet për informim publik	815.00	4,000.00	1,670.00	40.00	1,710.00
014300	Shpenzimet e përfaqësimit	3,894.10	4,454.50	4,077.10		4,077.10
014310	Drekat zyrtare	3,894.10	4,454.50	4,077.10		
014400	Shpenzime për vendime të gjykatave	284.88	1,000.00			

Funksionalizimi i kampusit të ri universitar dhe procesi i riakreditimit të programeve për njësitë akademike ishin prioritete të planifikuara nga menaxhmenti dhe K.D. Për periudhën raportuese janë angazhuar mjete në shumë prej 284.361.59€ që konsiderohet se janë plotësuar kërkesat sipas planit të rrjedhës së parasë. Angazhimi i mjeteve për pajisje për funksionalizim të laboratorëve në shumë prej 38.764.00€ ,preparateve kimike në shumë prej 7.521.00€, botimin e librave shkencore prej 9.500.00€ ,riakreditim të programeve në shumë prej 44.100.00€ dhe shërbime tjera kontraktuese në shumë prej 27.200.63€(angazhimi i profesorëve të jashtëm, përkthimi i dokumenteve strategjike dhe shpenzimet për organizimin e zgjedhjeve studentore) ishin prioritetet të përcaktuara nga Plani Strategjik i rishikuar për vitet 2019/2021 (44.100.00+27.200.63=71.300.63 - sh. Kontraktuese). Për mirëmbajtje të objekteve ,teknologjisë informative dhe pastërti të objekteve janë angazhuar 120.495.33€.

#### Pasqyrë krahasuese e realizimit për mallra dhe shërbime për vitet 2019/2021

Nr	Periudha e raportimit	Paga e realizuar	Indeksi i realizimit
1	Periudha janar/qershor/2019	118.180.13	16.86%
2	Periudha janar/qershor/2020	132.589.45	52.86%
3	Periudha janar/qershor/2021	179.290.82	56.12%

- Sfiduese për këtë vit fiskal do të jetë funksionalizimi i objekti nr.2 për të cilin është bërë pranim/dorëzimi. Furnizimi me inventar dhe funksionalizimi i laboratorëve do të jetë sfidë për të cilën menaxhmenti duhet të përcaktoj prioritetet të cilat do të harmonizohem me racionalizimin e shpenzimeve për këtë kategori. Mungesa e mjeteve do të ndikoi dukshëm në mirëmbajtjen dhe funksionalizim të kampusit universitar.

#### 4.3 SHPENZIMET KOMUNALE

Për këtë kategori janë alokuar mjete në shumë prej 110.459.00€ duke shpenzuar 101,614.99€ ose 91.99% të shumës së alokuar. Plani i rrjedhës së parasë për shpenzime komunale është i bazuar në shpenzimet e realizuara për periudhën tetor/nëntor të vitit 2020. Shuma e alokuar është me indeks prej 41.32% të mjeteve të planifikuara sipas buxhetit të aprovuar(215.200.00).

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi sipas buxhetit të aprovuar	Alokimi i mjeteve	Shpenzimet e realizuara	Indeksi i realizimit
		1	2	3	4=3/2*100
1	SHPENZIME KOMUNALE	215.200.00	110.459.00	101.614.99	91.99%

Në tabelën e poshtëshënuar, në mënyrë analitike, janë pasqyruar shpenzimet sipas kodeve ekonomike.

Nr	Përshkrimi	Shpenzimet e realizuara Janar/qershor/2020	Alokimi i mjeteve Janar/qershor/2021	Shpenzimet e realizuara Janar/qershor/2021	Indeksi i realizimit
1	2	3	4	5	6=5/4*100
1.	E. elektrike	11,264.53	33,000.00	21,262.67	64.43
2.	H. e ujit	1,478.79	6,000.00	2,933.46	48.89
3.	Mbeturina	2,088.00	4,999.00	2,320.00	46.40
4.	PTK	38,963.26	65,000.00	73,260.00	112.70
5.	Ngrëhja qendrore	952.13	1,460.00	1,838.86	125.95
6	Totali	54,746.71	110.459.00	101.614.99	91.99

**Pasqyrë krahasuese e realizimit të shpenzimeve komunale për vitet 2019/2021**

Nr.	Periudha e raportimit	Shuma e realizuar	Indeksi i realizimi
1	Periudha janar/qershor/2019	67.828.31	79.53%
2	Periudha janar/qershor/2020	54.746.71	53.60%
3	Periudha janar/qershor/2021	101.641.99	91.99%

Menaxhmenti është e nevojshme të hartoi planin për racionalizim të shpenzimeve gjithnjë duke pas në dijeni se me funksionalizimin e objektit nr2 shpenzimet do të jenë të ngritura dhe në mungesë të buxhetit do të reflektohen vështirësi në mbajtjen e rregullt të procesit mësikor.

**4.4 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE**

Planifikimi i mjeteve buxhetore për kategorinë e subvencioneve në shumë prej 100.000.00 euro është bërë për t'i stimuluar studentët për lirim nga pagesa, të bazuara sipas rregulloreve për shërbimet e ofruara, stimulim të studentëve të dalluar duke i shpërblyer me bursa si dhe rimbursimi i mjete për personelin akademik për publikim të punimeve shkencore në revista prestigjioze.

Për periudhën raportuese janë alokuar mjete në shumë prej 25.000.00€, mjetet janë planifikuar për të përmbush obligimet për pjesën e dytë për bursa për student në shumë prej 12.180.00€ dhe rimbursim të mjeteve në shumë prej 155,80€.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi sipas buxhetit të aprovuar	Alokimi i mjeteve	Realizimi për janar/qershor/2021	Indeksi i realizimit
	1	2	3	4	5=4/3*100
1	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	100.000.00	25.000.00	12.335.80	49.34%

Alokimi i mjeteve në shumë prej 75.000.00€ do të bëhet për periudhën tetor/dhjetor për të përmbushur obligimet për përfituesit e bursave për vitin akademik 2021/2022.

**Pasqyrë krahasuese e realizimit të subvencioneve për vitet 2019/2021**

Nr.	Periudha e raportimit	Shuma e realizuar	Indeksi i realizimi
1	Periudha janar/qershor/2019	55.000.00	55%
2	Periudha janar/qershor/2020	29.520.00	59.04%
3	Periudha janar/qershor/2021	12.335.80	49.34%



#### 4.5 INVESTIMET KAPITALE

Bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore për këtë vit fiskal, për investime kapitale janë planifikuar mjete në shumë prej 240.000.00€ që në krahasim me vitin 2020 masa buxhetore është zvogëluar për 410.000.00€ . Mjetet e planifikuara në shumë prej 240.000.00 euro janë ndarë për pajisjen e laboratorëve të njësive akademike, pajisje me teknologji informative e cila do të jetë në funksion të funksionimit të laboratorëve dhe ndërtimi, rregullimi i infrastrukturës së objekteve të ndërtuara.

Planifikimi për investime kapitale e strukturuara sipas projekteve

Nr.	Njësia akademike	Emërtimi i investimeve	Shuma
1.	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	Furnizimi me pajisje të inxhinierisë mekanike dhe kompjuterike	50.000.00
2.	Fakulteti i Gjeoshkencave	Furnizimi me pajisje për laborator të gjeoshkencave	80.000.00
3.	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	Furnizimi me pajisje për laborator të teknologjisë ushqimore	80.000.00
4.	Rektorat/njësi akademike	Furnizimi me pajisje për teknologji informative	20.000.00
5.	Rektorat/njësi akademike	Ndërtimi i infrastrukturës së universitetit/Kampusi	10.000.00
6.	Gjithsej		240.000.00

Pasqyrë e planifikimit, alokimit, zotimit dhe realizimit të mjeteve për periudhën janar/qershor/2021

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi sipas buxhetit të aprovuar	Alokimi i mjeteve	Realizimi për janar/qershor/2021	Zotimi i mjeteve	Mjetet e angazhuara	Indeksi realizimit
1.	1	2	3	4	5	6	$7=4/3*100$
	Investime kapitale	240.000.00	230.000.00	65.604.73	114.350.68	179.955.41	28.52

Pasqyrë e realizimit të investimeve të planifikuara të strukturuara sipas projekteve të planifikuara.

Nr.	Njësia akademike	Emërtimi i investimeve	Realizimi për janar/qershor/2020	Alokimi i mjeteve/janar qershor/2021	Realizimi për janar/qershor/2021
1.	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	Furnizimi me pajisje të inxhinierisë mekanike dhe kompjuterike		50.000.00	
2.	Fakulteti i Gjeoshkencave	Furnizimi me pajisje për laborator të gjeoshkencave	18.664.60	80.000.00	45.639.13
3.	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	Furnizimi me pajisje për laborator të teknologjisë ushqimore	148.358.40	80.000.00	
4.	Rektorat/njësi akademike	Furnizimi me pajisje për teknologji informative		20.000.00	19.965.60
5.	Rektorat/njësi akademike	Ndërtimi i infrastrukturës së universitetit/Kampusi	9.835.06		
6.	Gjithsej		176.858.06	230.000.00	65.604.73

Në tabelën e poshtëshënuar është pasqyruar gjendja e realizimit të investimeve të planifikuara kapitale.

Kodi	EMERTIMI I PROJEKTEVE	Planifikimi bazuar ne Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore per vitin 2021	ALOKIMI I BUXHETIT	OBLIGIMET FINANCIARE PER KONTRATAT E NENSHKRUAR/2020	REALIZIMI I OBLIGIMEVE TE BARTURA NGA 2020/	OBLIGIMET FINANCIARE PER KONTRATEN E NENSHKRUAR/2021	ZOTIMI I MJETEVE SIPAS KERKESAVE	KOMENTE
15260	Furnizimi me pajisje për laborator te Fakultetit te Gjeoshkencave/FGJ	80000	80000	45653.13	45639.13	34169.59	34336.61	
	Furnizimi me dy digestor për djegjen e substancave te FGJ			22950.00	22950.00			
	Furnizimi dhe vendosja e ventilimit e laboratorët e FGJ			12152.61	12152.61			
	Furnizimi me pajisje për laboratorët e FGJ			656.67	642.60			
	Furnizimi me pajisje për laboratorët e FGJ			818.92	818.92			
	Furnizimi me pajisje për laboratorët e FGJ			9075.00	9075.00			
	Furnizimi me pajisje për laboratorët e FGJ					34169.59	34336.61	Shuma prej 14336.91 është cotuar, është përfunduar operatori dhe është në fazën e implementimit.
15259	Furnizimi me pajisje për laborator te Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore/FTU	80000.00	80000.00				80000.00	
	Furnizimi me pajisje për laborator te Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore/FTU	80000.00	80000.00				80000.00	Mjetet janë cotuar sipas specifikimit nga FTU dhe sipas vendimit të OSHD, procesi është në fazën e rëndëritimit.
15258	Furnizimi me pajisje për laborator te FIMK	50000.00	50000.00					
	Furnizimi me pajisje për laborator te FIMK							Bazuar ne planin e pritur per vitin 2021 mjetet me shume pra 50.000.000 janë mjetet te parangazhuara.
14040	Ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës ne Universitetin e Mitrovicës	10000.00						
	faza e pare e ndërtimit te fushave sportive							Bazuar ne planin e pritur per vitin 2021 mjetet e planifikuara te procesit i ofertimit te fushave sportive/2021.
15261	Furnizim me pajisje të teknologjisë Informative	20000.00	20000.00	19965.6	19965.6			
	Furnizimi me softver për laboratorë dhe hapësira tjera ne kampus			19965.6	19965.6		14.07	
	<b>Totali i investimeve te planifikuara</b>	<b>240000.00</b>	<b>230000.00</b>	<b>65618.73</b>	<b>65604.73</b>		<b>114350.68</b>	

Nga pasqyra e lartë shënuar vërehet se mjetet e planifikuara sipas planit të rrjedhës së parasë janë alokuar konform dinamikës së planifikuar .Bazuar në dispozitat e Ligjit mbi Buxhetin janë ndarë mjete për obligime të bartuara nga viti 2020(situata e menaxhimit me Covid 19 dhe vendimet e imponuara nga MF) në shumë prej 65.618.73€ dhe shuma prej 164.381.27 bazuar në strukturën e investimeve të planifikuara.

1. Ofertat sipas strukturës së projekteve për furnizim të pajisjeve për laboratorët e njësive akademike (FTU dhe FGJ në total prej 114.350.68€ )janë shpallur, është përzgjedh operatori mirëpo për shkak ankesave dhe vendimeve nga OSHP procesi i ofertimit është kthyer në ritenderim.
2. Shuma e planifikuar për pajisjen e laboratorit për FIMK për shkak të specifikave (operatori nuk ka respektuar afatet) kontrata është ndërprerë dhe njësia kërkuese është obliguar që të procedoj projekt të ri në shumë prej 50.000.00€.
3. Ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës së jashtme në shumë prej 10.000.00€ sipas rishikimit të buxhetit është ridestinuuar për projektin- furnizimi me pajisje për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara prej 17.40 ha.


## 5. TË HYRAT VETANAKE

Të hyrat vetanake të planifikuara për vitin fiskal 2021 për Universitetin e Mitrovicës janë në shumë prej 114.661.00 euro që në krahasim me vitin 2020 janë në nivelin e njëjtë dhe s'kanë pësuar ndryshime. Planifikimi i të hyrave vetanake është bërë duke u bazuar në numrin e studentëve aktiv , lartësinë/çmimet e përcaktuara sipas Udhëzimit administrativ të MASHT-it me nr. 17/2014 për përcaktim të lartësisë së shërbimeve të ofruara për student, shitja e shërbimeve për persona fizik dhe juridik nga shërbimet e ofruara nga institutet e themeluara nga njësitë akademike dhe Qendra për Ndërmarrësi dhe Inovacione.

Të hyrat e planifikuara sipas Ligjit mbi Buxhetit për UIBM për vitin fiskal 2021 mund të shpenzohen vetëm për përmbushjen e obligimeve për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje dhe nuk mund të shpenzohen për qëllime tjera.

Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin fiskal 2021 e strukturuar sipas shërbime administrative të ofruara për studentët e UIMB:

Nr.	EMËRTIMI I TË HYRAVE VETANAKE	Çmimi për shërbim
1	Vërtetim për certifikatë të notave	1,499.00
2	Për vërtetim për diplomë	1,030.00
3	Për mbrojtje të diplomave master	900.00
4	Për paraqitje të provimeve-master	4,902.50
5	Për provim pranues	6,310.00
6	Për secilin provim të pranuar me rastin e transferit	785.00
7	Për ndrim të fakulteti/departamenti	750.00
8	Për regjistrimin e semestrit të rregullt-bachelor	51,767.25
9	Për regjistrimin e semestrit të rregullt-master	31,717.25
10	Për shitjen e shërbimeve për komunitetin e biznesit dhe personave fizike	15,000.00
11	Gjithsej	114,661.00



Nga pasqyra e lartë shënuar vërehet se pjesëmarrje më të madhe në strukturën e të hyrave vetanake e kanë të hyrat nga regjistrimi i studentëve bachelor në shumë 51,767.25€ ose me indeks prej 45.14%, regjistrimi i studentëve master në shumë prej 31,717.25€ ose me indeks prej 27.66% dhe 15,000.00€ nga shitja e shërbimeve ose 13.08% në krahasim me të hyrat e planifikuara për vitin fiskal 2021. Pjesëmarrja e të hyrave vetanake në totalin e burimeve buxhetore (buxheti final) për vitin 2021 (3.886.978.50 euro) është me indeks prej 2.95%.

Të hyrat e planifikuara mund të pësojnë ndryshime varësisht nga implementimi i vendimit të Qeverisë për zvogëlim të shumës së planifikuar për regjistrim të semestrit për student si dhe vonesa në hartimin dhe zbatimin e rregullores për krijim e të hyrave vetanake në nivel të universitetit.

Pasqyrë e planifikimit të hyrave vetanake e strukturuar sipas njësive akademike

Nr.	Përshkrimi i të hyrave pagesave	FAKULTETIN/NJËSIA AKADEMIKE						
		FIMK	FTU	FGJ	EDUKIM	JURIDIK	EKONOMIK	TOTALI
1	Vërtetim për certifikatë të notave	350.00€	270.00 €	230.00 €	249.00 €	200.00 €	150.00 €	1,499.00 €
2	Për vërtetim për diplomë	230.00 €	190.00 €	180.00 €	170.00 €	140.00 €	120.00 €	1,030.00€
3	Për mbrojtje të diplomave master	300.00 €	400.00 €	200.00 €				900.00€
4	Për paraqitje të provimeve-master	800.00€	2,502.50€	1,600.00€				4,902.50€
5	Për provim pranues	1,000.00€	1,200.00€	900.00€	1,800.00€	800.00€	610.00€	6,310.00€
6	Për secilin provim të pranuar me rastin e transferit	145.00€	140.00€	125.00€	150.00€	115.00€	110.00€	785.00€
7	Për ndrim fakulteti /departamenti	125.00€	130.00€	135.00€	140.00€	120.00€	100.00€	750.00€
8	Për regjistrimin e semestrit të rregullt-bachelor	12,250.00€	7,150.00€	2,600.00€	17,825.00€	8,642.25€	3,300.00€	51,767.25€
9	Për regjistrimin e semestrit të rregullt-master	5,750.00€	14,967.25€	11,000.00€				31,717.25€
10	Për shitjen e shërbimeve për komunitetin e biznesit dhe personave fizike	3,500.00€	6,000.00€	3,500.00€			2,000.00€	15,000.00€
<b>GJITHSEJ</b>		<b>24,450.00 €</b>	<b>32,949.75 €</b>	<b>20,470.00 €</b>	<b>20,334.00 €</b>	<b>10,017.25 €</b>	<b>6,390.00 €</b>	<b>114,661.00 €</b>

### 5.1. Planifikimi i të hyrave vetanake për periudhën Janar/Qershor 2021

Të hyrat e planifikuara për periudhën raportuese janar/qershor/2021 janë 57.330.50 euro të planifikuara të inkasohen nga shërbimet e ofruara administrative për student. Planifikimi i të hyrave vetanake është bërë duke u bazuar në numrin e studentëve aktiv dhe lartësinë/çmimet e përcaktuara sipas Udhëzimit administrativ të MASHT-it me nr. 17/2014 për përcaktim të lartësisë së shërbimeve të ofruara për student.


Në tabelën e poshtëshënuar janë pasqyruar të hyrat vetanake të planifikuara dhe bartja e të hyrave vetanake nga viti fiskal 2020.

THV të planifikuara sipas Ligjit mbi Buxhetin për vitin fiskal 2021	THV të planifikuara për periudhën Janar/qershor/2021	THV të bartura nga viti 2020
1	2	3
114.661.00	57.330.50€	

Pasqyrë e të hyrave të planifikuara e strukturuar sipas njësive akademike

Nr.	Përshkrimi i të hyrave pagesave	FAKULTETIN/NJËSIA AKADEMIKE						
		FIMK	FTU	FGJ	EDUKIM	JURIDIK	EKONOMIK	TOTALI
1	Vërtetim për certifikate të notave	175.00€	135.00€	115.00€	124.50€	100.00€	75.00€	749.50€
2	Për vërtetim për diplome	115.00€	95.00€	90.00€	85.00€	70.00€	60.00€	515.00€
3	Për mbrojtje të diplomave master	150.00€	200.00€	100.00€				450.00€
4	Për paraqitje të provimeve-master	400.00€	1,251.25€	800.00€				2,451.25€
5	Për provim pranues	500.00€	600.00€	450.00€	900.00€	400.00€	305.00€	3,155.00€
6	Për secilin provim të pranuar me rastin e tranferit	75.00€	70.00€	62.50€	75.00€	57.50€	55.00€	392.50€
7	Për nderim fakulteti/departamenti	62.50€	65.00€	67.50€	70.00€	60.00€	50.00€	375.00€
8	Për regjistrimin e semestrit të rregullt-bachelor	6,125.00€	3,575.00€	1,300.00€	8,912.50€	4,321.12€	1,650.00€	25,883.62€
9	Për regjistrimin e semestrit të rregullt-master	2,875.00€	7,483.62€	5,500.00€				15,858.62€
10	Për shitjen e shërbimeve për komunitetin e biznesit dhe personave fizike	1,750.00€	3,000.00€	1,750.00€			1,000.00€	7,500.00€
<b>GJITHSEJ</b>		<b>12,225.00€</b>	<b>16,474.87€</b>	<b>10,235.00€</b>	<b>10,167.00€</b>	<b>5,008.62€</b>	<b>3,195.00€</b>	<b>57,330.50€</b>

### Planifikimit i të hyrat vetanake Janar-Qershor



Pjesëmarrja e të hyrave vetanake varret nga numri i studentëve, lartësia për shërbime, azhureteti dhe përgjegjësia për ofrim të shërbimeve administrative. Shuma prej 12,225.00 euro është planifikuar nga FIMK dhe me pjesëmarrje prej 21.32% në të hyrat e planifikuara për periudhën raportuese, FTU me shumë prej 16,474.87 euro dhe pjesëmarrje prej 28.73%, FGJ me shumë prej 10,235.00 euro dhe pjesëmarrje prej 17.85%, Fakulteti i Edukimit me shumë prej 10,167.00 euro ose me pjesëmarrje prej 17.73%, Fakulteti Juridik me shumë prej 5,008.62 dhe pjesëmarrje prej 8.73% dhe Fakulteti Ekonomik me shumë prej 3,195.00 euro dhe pjesëmarrje prej 5.57 % në të hyrat e planifikuara për periudhën janar/qershor (57.330.50 euro).

#### 5.2. Realizimi/inkasimi i të hyrave vetanake për periudhën Janar/Qershor 2021

Për periudhën raportuese të hyrat vetanake janë realizuar në shumë prej 11,121.50 euro dhe janë më të ulëta për 46,209.00 euro në krahasim me të hyrat vetanake të planifikuara janar/qershor/2021 (57.330.50 €) ose më të ulëta për 26,834.00 euro në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020. Indeksi i realizimit është 19.40% në krahasim me të hyrat e planifikuara. Në inkasimin e të hyrave të planifikuara ndikoi vendimi i Qeverisë për lirimin nga pagesa për studentët (niveli bachelor-100%) dhe zvogëlimi i tarifave prej 50% (niveli master) të regjistruar në vitin akademik 2020/2021 /semestri dimëror.

#### Realizimi i të hyrave vetanake për periudhën janar/qershor të vitit fiskal 2021


	THV të planifikuara sipas Ligjit mbi Buxhetin për vitin fiskal 2021	Realizimi/inkasimi i THV për Janar – qershor 2021	Alokimi i të hyrave vetanake për vitin 2021	Shpenzimi i THV për 2021
	1	2	3	4
1	114.661.00€	11,121.50	8.079.00	

Për periudhën raportuese janë alokuar mjete buxhetore në shumë prej 8.079.00€. Të hyrat e alokuara për këtë periudhë për përmbushje të obligimeve për kategorinë ekonomike paga dhe do të realizohen në fund të vitit fiskal 2021.

**Pasqyrë e realizimit të hyrave vetanake për periudhen janar/qershor 2021 e strukturuar sipas njësive akademike:**

Nr.	Përshkrimi i të hyrave pagesave	FAKULTETIN/NJËSIA AKADEMIKE						TOTALI
		FIMK	FTU	FGJ	EDUKIM	JURIDIK	EKONOMIK	
1.	Për certifikatë të diplomës	360.00€	45.00€	30.00€	185.0€	30.00€	120.00€	770.00€
2.	Për certifikatë të notave	182.50€	102.50€	62.50€	170.€	25.00€	42.50€	585.00€
3.	Për diplomë	405.00€	140.00€	65.00€	185.00€	30.00€	120.00€	945.00€
4.	Për diplomë dubllkatë							
5.	Për paraqitjen e provimeve e studimeve Master	252,50€	857.50€	820.00				1,930.00€
6.	Për mbrojtjen e diplomës së studimeve Master	500.00€	1,800.00€	500.00€				2,800.00€
7.	Për kërkesë për transferimi të notës/notave	50.00€		4.00€	4.50€	2.00€	11.00€	71.50€
8.	Pë ndërrim fakulteti / departamenti							
9.	Për ndërrim të kartelës	5.00€			15.00€			20.00€
10.	Për provim pranues Bachelor							
11.	Për provim pranues Master							
12.	Për semestër për studentet Bachelor	425.00€	175.00€	100.00€	200.00€		150.00€	1,050.00€
13.	Për semestër për studimet postdiplomike-Master	450.00€	1,275.00€	1,200.00€		25.00€		2,950.0€
14.	<b>GJITHSEJ</b>	<b>2,630.00€</b>	<b>4,395.00€</b>	<b>2,781.50€</b>	<b>759.50€</b>	<b>112.00€</b>	<b>443.50€</b>	<b>11,121.50€</b>


**Të hyrat vetanake te realizuara sipas njësive akademike**



**Pasqyrë krahasuese e realizimit të hyrave për vitet 2019/2021:**

Nr	Periudha e raportimit	Realizimi i të hyrave	Indeksi i realizimit
1	Periudha janar/qershor/2019	50,932.50€	43.94%
2	Periudha janar/qershor /2020	37,955.50€	33.10%
3	Periudha janar/qershor /2021	11,121.50€	19.39%

### Te hyrat e realizuar sipas dinamikes mujore



### 5.3. TË HYRAT NGA DONACIONET PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR/2021

Universiteti i Mitrovicës përmes projekteve të financuara nga donacionet synon që të bëjë: përmirësimin e kulturës së kërkimeve në arsimin e lartë, ngritjen e profesionalizmit dhe cilësisë së arsimit fillestar, metodave inovative të mësimdhënësve të matematikës dhe zhvillimin e cilësisë së bashkëpunimit ndërkombëtar.

Pasqyrë e projekteve nga donacionet- EU-UNIONI EUROPIAN

Përshkrimi	Buxheti 2021	Të Alokua	Shpenzuar	Zotimi në pritje	Mbetja
Përmirësimi i Kulturës të Kërkimeve në Arsimin e Lartë	5,487.24€	5,487.24€	3,598.00€		1,889.24€
Paqja dhe Diversiteti	19.50€	19.50€	19.50€		0.00€
Ngritja e Profesionalizimit dhe Cilësisë së Arsimit Fillestar	26,432.50€	26,432.50€	0.00€		26,432.50€
Metodat Inovative në Mësimdhënës të Matematikës	15,935.97€	15,935.97€	5,120.00€		10,815.97€
Fuqizimi i të Rinjëve dhe Grave drejt Punësimit	234.00€	234.00€	234.00€		0.00€
Zhvillimi i Cilësisë së Bashkëpunimit Ndërkombëtarë	6,610.96€	6,610.96€	414.96€	2,298.47€	3,897.53€
<b>TOTALI</b>	<b>54,720.17</b>	<b>54,720.17</b>	<b>9,386.46€</b>	<b>2,298.47€</b>	<b>43,035.24</b>

Drejtori i zyrës për buxhet dhe financa

Besim Kurti

